

Fjalë e mbajtur e kryetarit Hivzi Islami në mbledhjen komemorative të ASHAK-ut me rastin e vdekjes së akademik Engjëll Berishës, 16. 02. 2015

E nderuara familje Berisha,  
I nderuari ministër i Ministrisë së Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë, prof. Arsim Bajrami  
Të nderuar kolegë dhe miq,  
Zonja dhe zotërinj,

Duke qenë në përgatitje të shënimit të 7-vjetorit të Pavarësisë së Kosovës erdhi lajmi i pikëllueshëm se u nda nga jeta akademik Engjëll Berisha. Prandaj jemi tubuar sot këtu, në mjediset e Akademisë, për t'i bërë nderimet e fundit anëtarit të rregullt të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe ish-sekretarit të përgjithshëm të saj, muzikologut, historianit të muzikës, njohësit të mirë të zhvillimeve të muzikës moderne shqiptare dhe avancimit të saj, akademik Engjëll Berishës. Profesor Berisha ishte personalitet me një rrugë të bujshme jetësore, që la gjurmë të pashlyeshme në fushën arsimore-edukative, nga shkolla e mesme deri te Universiteti, në trashëgiminë tonë kulturore dhe në jetën publike. Akademik Berisha u shqua dhe në organizimin dhe drejtimin e institucioneve kulturore-pedagogjike dhe në afirmimin e vlerave kulturore-civilizuese dhe kombëtare të shqiptarëve.

Ju ftoj që me një minutë heshtje ta nderojmë bashkëshortin, prindin, gjyshin, mikun dhe kolegun tonë të dashur akademik Engjëll Berishën.

Lavdi!

Me këtë rast Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës i shpreh ngushëllimet më të sinqerta familjes së akademik Engjëll Berishës, si dhe të gjithë miqve dhe shokëve të tij të shumtë anë e mbanë Kosovës dhe trojeve shqiptare. Familjes Berisha dhe Akademisë u kanë arritur shumë telegrame ngushëllimi nga miqtë dhe shokët e Republikës së Kosovës. Në pamundësi që t'i lexojmë të gjitha, po e lexojmë vetëm telegramin e Presidentes së Republikë së Kosovës znj. Atifete Jahjaga.

Për jetën dhe veprën e akademik Engjëll Berishës do të flasë sekretari i Seksionit të Arteve anëtar i korresp. akademik Luan MULLIQI.